



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TEPELENË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 438/6 prot.

Tepelenë, më 27.02.2026

V E N D I M

Nr. 18, datë 26.02.2026

**“PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË PERFORMANCËS SË KËSHILLIT BASHKIAK
TEPELENË PËR VITIN 2025”**

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, si dhe në bazë të Rregullores së Këshillit Bashkiak Tepelenë, pas shqyrtimit të raportit të paraqitur nga Sekretari i Këshillit Bashkiak për vitin 2025, Këshilli Bashkiak:

VENDOSI:

1. Miratimin e raportin të performancës së Këshillit Bashkiak Tepelenë për vitin 2025, sipas dokumentit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Sekretari i Këshillit Bashkiak për publikimin e raportit në faqen zyrtare të Bashkisë Tepelenë.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

SEKRETAR KËSHILLI

Valbona ÇELA

Miratuar me 12 (dymbëdhjetë) vota
Vota Pro 12 (dymbëdhjetë)vota
Vota Kundër 0
Vota Abstenim 0
Zbardhur më datë 27.02.2026

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

ARBEN GUMENI





BASHKIA TEPELENË

KËSHILLI BASHKIAK

RELACION

RAPORTI I PERFORMANCES SË KËSHILLIT BASHKIAK TEPELENË PËR VITIN
2025

Këshilli Bashkiak Tepelenë, si organ përfaqësues dhe vendimmarrës i vetëqeverisjes vendore, ka ushtruar përgjegjësitë e tij në përputhje me Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe me Rregulloren e funksionimit të Këshillit. Veprimtaria e tij është zhvilluar mbi bazën e parimeve të demokracisë vendore, transparencës, përgjegjshmërisë dhe mbrojtjes së interesit publik, duke përdorur me efektivitet burimet njerëzore, financiare, fizike dhe natyrore.

Raporti i Performancës për vitin 2025 pasqyron punën dhe aktivitetet e Këshillit Bashkiak Tepelenë në zbatim të Vendimit nr. 66, datë 31.10.2024, “Për miratimin e Planit të Vendimmarrjes, Planit të Konsultimeve Publike dhe Buxhetit të Këshillit Bashkiak Tepelenë për vitin 2025”.

Gjatë këtij viti, Këshilli ka ushtruar në mënyrë aktive rolin e tij vendimmarrës, përfaqësues dhe mbikëqyrës/monitorues, duke garantuar transparencë, llogaridhënie dhe pjesëmarrje të qytetarëve në proceset e qeverisjes vendore.

VENDIMMARRJA:

Gjatë vitit 2025 janë realizuar në total 14 mbledhje të Këshillit, 12 prej tyre të radhës dhe 2 mbledhje jashtë radhe me kërkesë të Kryetarit të Bashkisë.

Në total janë miratuar 79 vendime prej te cilave 26 vendime të konfirmuara nga institucioni i Prefektit të Qarkut Gjirokastrë, dhe 53 vendime me karakter individual

Pjesëmarrja e këshilltarëve në mbledhjet e Këshillit bashkiak ka qenë në masën 80%, në cdo mbledhje.

Kryesia e Këshillit Bashkiak ka funksionuar rregullisht duke zhvilluar mbledhjet për diskutimin e pikave të rendit të ditës të propozuara nga ekzekutivi dhe ushtruar vendimmarrjen për thirrjen e mbledhjeve të këshillit dhe publikimin e rendit të ditës të saj.

Mbledhjet e Komisioneve tashmë parashikohen dhe publikohen si pjesë e rendit të ditës së mbledhjeve të këshillit. Janë realizuar 16 mbledhje komisionesh. Mbetet sfidë angazhimi më i madh i këshilltarëve në mbledhjet e komisioneve, si dhe dokumentimi i veprimtarisë, kontributeve dhe mendimeve që jepen nga anëtarët e komisioneve.

Gjatë 2025 mbledhjet janë zhvilluar në sallën e Këshillit Bashkiak. Të gjitha mbledhjet e Këshillit Bashkiak janë transmetuar live në faqen e Facebook- të Këshillit Bashkiak, cka ka bërë që komuniteti të ndjekë direkt mbledhjen madje të jape dhe mendimet dhe sugjerimet e tij për vendimet dhe çështjet që janë shqyrtuar.

Këshilli Bashkiak Tepelenë ka hapur kanalin e tij zyrtar në platformën YouTube, si një domosdoshmëri për arkivimin dhe ruajtjen afatgjatë të të gjitha mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Tepelenë. Ky kanal shërben për rritjen e transparencës, garantimin e aksesit publik në vendimmarrje dhe informimin e vazhdueshëm të qytetarëve mbi veprimtarinë e Këshillit. Nëpërmjet këtij kanali, çdo qytetar mund të ndjekë në çdo kohë mbledhjet e zhvilluara dhe diskutimet e realizuara.

Në vitin 2025 janë regjistruar 974 ndjekës, në faqen e FB. Transparenca e mbledhjeve të këshillit si dhe publikimi i projekt-vendimeve dhe proces-verbaleve të mbledhjeve, kanë rritur mundësinë për akses të qytetarëve në vendimmarrje.

Gjatë 2025 kemi implementuar Planin e aktiviteteve të Këshillit Bashkiak të shoqëruar me buxhetin përkatës prej 200.000 lekë, I cili është realizuar në masën 80%.

Ndërkohë që kemi vijuar punën duke implementuar rregulloret e Këshillit dhe Planin e Aktiviteteve, rezulton se në bashkëpunim me këshilltarët, administratën dhe komunitetin kemi arritur zbatimin e planit të aktiviteteve në masën 80%.

Sfidë për vitin 2025, e cila do të vijojë edhe në vitin 2026, mbetet funksionimi i plotë dhe efektiv i komisioneve, trajnimi i vazhdueshëm i tyre, si dhe dokumentimi dhe publikimi i rregullt i veprimtarisë së Këshillit Bashkiak Tepelenë. Kjo synon rritjen e transparencës, përmirësimin e procesit të vendimmarrjes, forcimin e përfaqësimit komunitar dhe mbrojtjen e interesit publik.

Në këtë proces këshilli është asistuar nga Projekti “Bashki të Forta”, gjë e cila do të vijojë edhe për 2026 si në drejtim të zhvillimit të trajnimeve dhe ofrimit të dokumentave e materialeve ndihmëse, ashtu edhe në asistencën e vazhduar gjatë proceseve. Kjo, me qëllim rritjen e standardeve të punës së këshillit.

PËRFAQESIMI

Roli përfaqësues i Këshillit Bashkiak gjatë vitit 2025 është fokusuar në komunikimin e vazhdueshëm me komunitetin, si dhe në tërheqjen e mendimeve dhe sugjerimeve si në formë online, ashtu edhe në formë shkresore.

Përmirësimi i faqes zyrtare të Këshillit Bashkiak gjatë 6-mujorit të fundit ka qenë një proces i rëndësishëm dhe pozitiv. Struktura e re e faqes është ndërtuar sipas programit model të transparencës, falë asistencës së ekspertit të projektit “Bashki të Forta”, i cili ka dhënë një kontribut të vlefshëm në përmirësimin dhe funksionalitetin e saj.

Rritja e sasisë së dokumentacionit të Këshillit që publikohet në faqen zyrtare dhe në rrjetin social Facebook u ka krijuar qytetarëve më shumë akses gjatë vitit 2025 për të dhënë mendimet e tyre online, si dhe për të adresuar kërkesa, ankesa apo problematika të tjera me interes për komunitetin.

Këshilltarët kanë përfaqësuar zonat nga të cilat vijnë, duke sjellë në Këshill problematikat e banorëve dhe zërin e tyre. Njëkohësisht, Këshilli Bashkiak, në bashkëpunim me administratën, ka zhvilluar konsultime publike për aktet që janë subjekt i konsultimit publik, duke garantuar transparencë dhe përfshirje qytetare në procesin vendimmarrës.

Në zbatim të Ligjit 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit 146/2014 “Për konsultimin publik” dhe duke u bazuar në Rregulloren e Konsultimeve Publike, janë organizuar gjatë vitit 2025, 3 Konsultime Publike;

“Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2026-2028.”

“Për miratimin e buxhetit për vitin 2026”.

Konsultimi publik është dokumentuar në Regjistrin e Konsultimeve Publike dhe është shoqëruar me njoftimin për konsultim publik, kalendarin e takimeve, procesverbalet përkatëse, si dhe me një raport drejtuar Kryetarit të Bashkisë për prezantimin, shqyrtimin dhe marrjen në konsideratë, si dhe për buxhetimin sipas mundësive financiare, të kërkesave dhe sugjerimeve të paraqitura nga qytetarët.

Takimet publike janë mbajtur dhe pasqyruar në faqen zyrtare dhe në rrjetet sociale të Këshillit Bashkiak. Në këto takime kanë marrë pjesë përfaqësues të Këshillit Bashkiak dhe të Bashkisë, qytetarë dhe banorë të njësive administrative, si dhe përfaqësues të grupeve të interesit. Gjatë zhvillimit të takimeve janë respektuar të gjitha procedurat përkatëse, konkretisht:

- Mbajtja e procesverbaleve
- listë-prezencës
- Dokumentimi me foto

Pas përfundimit të konsultimeve publike dhe zbatimit të procedurave ligjore, Këshilli Bashkiak miratoi projekt-vendimet përkatëse, të cilat më pas morën konfirmimin e ligjshmërisë nga institucioni i Prefektit të Qarkut Gjirokastrë.

Në zbatim të rregulloreve janë dokumentuar në Regjistrin e Kërkesë-Ankesave 46 kërkesa/ankesa për vitin 2025, të cilat janë adresuar dhe kanë gjetur zgjidhje në masën 50% në koordinim dhe bashkëpunim me ekzekutivin.

Në bashkëpunim me projektin “**Bashki të Forta**” janë organizuar sesione informuese për qytetarët me fokus në:

- Organizimin dhe funksionimin e Këshillit Bashkiak;
- Pjesëmarrjen qytetare në procesin e vendimmarrjes;
- Antikorrupsionin si pjesë e agjendës së veprimtarisë së Këshillit Bashkiak;
- Rolin e shoqërisë civile në funksion të një Këshilli Bashkiak të suksesshëm dhe transparent.

Këto sesione synojnë rritjen e transparencës, forcimin e llogaridhënies dhe nxitjen e angazhimit aktiv të qytetarëve në qeverisjen vendore.

MBIKËQYRJA:

Në lidhje me rolin mbikqyrës dhe monitorues të Këshillit, përveç ushtrimit të këtij roli nëpërmjet sqarimeve dhe pyetjeve nga ana e këshilltarëve në drejtim të administratës për projekt - vendimet e propozuara nga ekzekutivi, në zbatim të planit të aktiviteteve të vitit 2025, u realizuan dhe u paraqitën në këshill informacionet dhe raportet nga administrata sipas kërkesave detyruese ligjore, si dhe atyre të bëra nga vetë këshilli sipas planit të aktiviteteve.

Gjatë periudhës raportuese, në Këshillin Bashkiak janë paraqitur këto raportime dhe informacione nga administrata e Bashkisë Tepelenë:

- Informacion nga Drejtoria e MZSH mbi masat paraprake për parandalimin e zjarreve dhe përballimin e emergjencave civile.
- Raportim nga Drejtoria e Shërbimeve Publike mbi masat e marra për ruajtjen dhe zgjerimin e ambienteve të gjelbëruara në qytet.
- Raportim nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar mbi zbatimin e buxhetit.
- Raportim nga Njësitë Administrative mbi problematikat dhe veprimtarinë në njësitë përkatëse administrative.
- Informacion nga Drejtoria e Arsimit, Kulturës dhe Kujdesit Social mbi aktivitetet dhe çështjet në fushat përkatëse.
- Prezantimi i Raportit të Performancës së Bashkisë Tepelenë për vitin 2024.
- Informacion nga Drejtoria e Zhvillimit Rural “Mbi kontrollin për zbatueshmërinë e kërkesave të përcaktuara në kontratat e qirasë ‘Për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik dhe Për dhënie në përdorim të tokës bujqësore të pandarë, për kontratat e lidhura me afat të gjatë.

Në funksion të rolit të tij monitorues, Këshilli Bashkiak duhet të kërkojë nga administrata paraqitjen e raporteve periodike sqaruese mbi zbatimin, ecurinë dhe problematikat e hasura në ekzekutimin e vendimeve të miratuara.

Këto raporte duhet të përmbajnë të dhëna konkrete mbi procesin e ndjekur për zbatimin e vendimit, masat e ndërmarra nga strukturat përgjegjëse, afatet e realizimit, apo problematikat e hasura gjatë zbatimit, të mëtejshëm.

Në përfundim, duke ju falenderuar secilin për kontributin dhe angazhimin, si dhe duke falenderuar bashkëpunëtorët që asistojnë në aktivitetin e Këshillit të Bashkisë Tepelenë projektin “Bashki të Forta”, ju ftojme të bëheni pjesë aktive për përmirësimin e punës së këshillit nëpërmjet mendimeve, sygjërimeve dhe pjesëmarrjes suaj në aktivitetin e KB

Punë të mbarë dhe faleminderit!

SEKRETAR KËSHILLI

VALBONA ÇELI
Këshilli Bashkiak
Sekretaria

Adresa: Sheshi “Lord Bajron” Tepelenë

web: www.tepelena.gov.al E-mail: info@tepelena.gov.al